



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	13.01.2024
REFERENC-Ë:	23/6585/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Toni Mermer" Sh.p.k. Sojevë, Ferizaj , Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Reçak, Shtime
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit "Toni Mermer" Sh.p.k. Sojevë, Ferizaj, me nr. prot. 23/6585/MMPHI , me veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Reçak, Shtime

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin, "Toni Mermer" Sh.p.k. Sojevë, Ferizaj , Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Reçak, Shtime

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/6585/MMPHI
Datë: 13.01.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori "Toni Mermer" Sh.p.k. Sojevë, Ferizaj, me nr. prot. 23/6585/MMPHI, **pajiset me Leje Mjedisore**, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në ngastrën, Reçak, Shtime në ngastrën, nr. P- 72809071-00075-0 në sipërfaqe prej 0.98.00 ha, (9800m²), zona kadastrale Reçak, Shtime, sipas Pëlqimit Mjedisor i MMPHI-së.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Sistemi de- pluhurues të jetë funksional, gjatë transportit të gurit gëlqeror;
 - 2.3. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit që është përgjegjës për mjedis;
 - 2.4. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;

Faqe 2 nga 4



- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;
- 2.6. Të mirëmbahet në vazhdim sipërfaqja e rrethojës operuese dhe
- 2.7. Kriteve të përcaktuara me Vendimin e Pëlqimit mjedisor.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdimin e Lejes Mjedisore, Operatori "Toni Mermer" Sh.p.k. Sojevë, Ferizaj , me nr. prot. 23/6585/MMPHI, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në ngastrën, Reçak, Shtime në ngastrën, nr.P- 72809071-00075-0 në sipërfaqe prej 0.98.00 ha, (9800m2), zona kadastrale Reçak , Shtime, sipas Pëlqimit Mjedisor i MMPHI-së, është konstatuar se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për tu pajisur me Leje Mjedisore.


Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriteve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 17/4465/1-ZSP/301/17, të lëshuar me dt. 20.11.2017;
- Licensë shfrytëzimi të KPMM, me Nr.2129/KPMM/2020, me afat të vlefshmërisë deri me :10.06.2025;
- Leje Mjedisore, në bazë të cilës ka bërë kërkesë për vazhdim, nr.18./5391/ZSP/22/19, data e lëshimit: 18.01.2019

Operatori i ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori i ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për **Lëshimin e Lejes Mjedisore.**

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të këtij vendimi.


Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Shtime;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së